

Harmonizimi i standardeve të sigurisë dhe
cilësisë së produkteve ushqimore në mes të
KOSOVËS DHE SHQIPËRISË

Tetor 2014

Problemet me tregtinë e miellit



Seria e analizave mbi
integrimin ekonomik
KOSOVË-SHQIPËRI #2

HYRJE

Shqipëria dhe Kosova përveç se ndajnë aspekte të përbashkëta historike dhe kombëtare, janë edhe dy partnerë të rëndësishëm tregtarë. Për Shqipërinë Kosova zë vendin e tretë në renditjen e shteteve të eksportit (7% të eksporteve totale),¹ ndërsa për Kosovën Shqipëria renditet e dyta (15% të eksporteve totale) në renditjen e shteteve eksportuese në fund të vitit 2013.² Eksportet e Shqipërisë për në Kosovë përbëhen kryesisht nga metale bazë (52%) dhe produkte minerale (30%). Eksportet e Kosovës për në Shqipëri gjithashtu dominohen nga metalet bazë (54%), mirëpo produktet bimore, ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani zënë një peshë shumë të madhe me rreth 32%. Megjithatë Shqipëria dhe Kosova janë partnerë të rëndësishëm tregtarë, eksportet nga Kosova përbëjnë vetëm 1% të importit në Shqipëri, ndërsa eksporti nga Shqipëria përbën vetëm 4.5% të importit në Kosovë. Importet nga Shqipëria mbulohen vetëm në masën prej 40% me eksporte nga Kosova.

Figura 1. Tregtia në mes të Kosovës dhe Shqipërisë



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Më 11 janar 2014, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë nënshkruan një marrëveshje kornizë me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe lehtësimin e tregtisë.³ Marrëveshja kishte qëllim lehtësimin e transitit të mallrave nëpër dy

¹ INSTAT, Tregtia e Jashtme 2009-2013, <http://bit.ly/1D8VaDk>, (qasur më 14 tetor 2014)

² Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregtisë së Jashtme 2013, <http://bit.ly/101ksW1>, (qasur me 09 Tetor 2014)

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Marrëveshje Kuadër Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim në Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë, <http://bit.ly/ZnLaXC>, (qasur me 10 Tetor 2014)

territoret dhe rritjen e kapaciteteve për transit. Marrëveshja përmbante këto pika kryesore: a) fushat e bashkëpunimit; b) përmirësimi i shkëmbimit të informacionit elektronik; c) harmonizimi dhe thjeshtëzimi i procedurave të transimit; d) përmirësimi i zbatimit të deklarimit në doganë; dhe e) krijimi i grupeve të përbashkëta të punës për eliminim e barrierave jo-tarifore.

Brenda dy vitesh, Shqipëria ka bllokuar dy herë importin e miellit nga Kosova. Përderisa herën e parë arsyeja kishte qenë mungesa e analizave të aflotoksinës, herën e dytë kjo u bë me arsyetimin se mielli nga Kosova kishte nivelin e proteinës nën masën e kërkuar në udhëzimin e ri të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë problemet lidhur me harmonizimin e legjislacionit në fushën e standardeve të sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore, pjesë e marrëveshjes për tregti Kosovë-Shqipëri (Neni 2, pika A). Punimi merr për bazë rastin e bllokimit të eksportit të miellit nga Kosova për në Shqipëri. Së fundmi, punimi ofron disa rekomandime lidhur me përmirësimin e komunikimit në mes të dy shteteve në fushën e tregtisë si dhe krijimin e grupeve të përbashkëta teknike të cilët do të punonin në harmonizimin sa më të shpejtë të legjislacionit në fushën e sigurisë dhe cilësisë së produkteve.

Problemet me standardet e cilësisë së miellit

Me 15 korrik 2014, Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë z. Edmond Panariti kishte lëshuar një udhëzim *"për përcaktimin e treguesve të sigurisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t'u shitur te konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve tjera ushqimore"*.⁴ Ky udhëzim rregullonte vetëm cilësinë dhe sigurinë e miellit të grurit për konsum njerëzor të përgatitur nga mielli i zakonshëm dhe prodhuesit dhe importuesit e miellit kishin afat deri me 30 shtator 2014 të fillonin zbatimin e standardeve të reja.⁵ Sa i përket treguesve të cilësisë, udhëzimi ndër të tjera: a) rregullonte nivelin e pranueshëm të lagështisë; b) caktonte përbërësit të cilët lejohen të shtohen; c) kërkonte që niveli maksimal i metaleve të rënda, pesticideve dhe mykotoksinës të ishte në përputhje me udhëzimet e miratuara nga shteti shqiptar; dhe d)

⁴ Udhëzim Nr. 12, datë 15 korrik 2014 për Përcaktimin e Treguesve të Sigurisë dhe Cilësisë së Miellit të Grurit të Parapaketuar, për t'u Shitur të Konsumatori i Fundit ose për Prodhimin e Produkteve të tjera Ushqimore

⁵ Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë, Zbatim Rigoroz të Standardeve të Reja të Cilësisë dhe Sigurisë të Grurit dhe të Miellit Shqiptar, 25 Shtator 2014, <http://bit.ly/1vXnYeE>, (qasur me 10 Tetor 2014)

rregullonte standardet e higjienës, ambalazhimit, etiketimit dhe informacionit që duhet të përmbajë ky etiketim. Së fundmi, ky udhëzim kishte të bashkëlidhur edhe një tabelë e cila përcaktonte kufijtë e lejuar për disa tregues të miellit të grurit. Për më tepër, tabela specifikonte se niveli minimal i proteinave duhej të ishte "12.5% mbi bazën e peshës së thatë". Ishte pikërisht ky specifikim, i cili pastaj doli të ishte problematik në raport me eksportin e miellit të Kosovës drejt Shqipërisë.⁶

Si pasojë e moskomunikimit në mes të dy palëve dhe mosrespektimit të marrëveshjeve të përbashkëta, me hyrjen në fuqi të udhëzimit të lartpërmendur për cilësinë e miellit, në pikën doganore Morinë u bllokuan disa kamionë që eksportnin miell nga Kosova për në Shqipëri. Një bllokadë e tillë kishte vazhduar deri në vizitën e ministrit Panariti në Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në Kosovë më 8 tetor 2014. Sipas deklaratës për shtyp të lëshuar nga AUV, bllokada kishte ndodhur si pasojë e metodave të ndryshme laboratorike për testimin e mostrave të miellit, e cila pastaj kishte shkaktuar "keqkuptime" tek interpretimi i rezultateve tek autoritetet doganore shqiptare.⁷

Në bazë të udhëzimit administrativ 2003/03, institucioni përgjegjës për kontrollimin dhe kryerjen e analizave dhe testeve me qëllim të certifikimit të prodhimeve bujqësore në Kosovë është Instituti Bujqësor në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.⁸ Sipas shpjegimit të Institutit Bujqësor, në Kosovë testimi i mostrave të miellit bëhet mbi peshën e miellit të lagësht, ndërsa Shqipëria një test të tillë e bënte mbi bazën e peshës së miellit të thatë. Për këtë arsye, niveli i proteinave në Kosovë kishte dalë të jetë më i ulët se 12.5%, mirëpo 11% e proteinave të standardit të Kosovës, përkthehej në 12.5% të nivelit të proteinave të standardit të Shqipërisë.⁹ Gjithashtu, vlen të përmendet se sipas Institutit të Shëndetit Publik të Kosovës, prania me e ulët se 12.5% e proteinave në miell nuk paraqet ndonjë rrezik për shëndetin publik për arsye se mielli nuk ishte burimi i vetëm i marrjes së proteinave.¹⁰

⁶ Ferma Ime- Portal Informativ dhe Këshillues për Bujqësi, Bllokohet Mielli i Kosovës, Nuk i Përmbush Standardet e BE-së, <http://bit.ly/1Cd31NF>, (qasur me 10 Tetor 2014).

⁷ AUV, Nuk do të Ketë Barriera për Tregtim të Miellit nga Kosova për në Shqipëri, 09 Tetor 2014, <http://bit.ly/ZAXhAQ>, (qasur me 10 Tetor 2014).


⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Udhëzim Administrativë për Rolin dhe Mandatin e Institutit Bujqësorë të Kosovës, <http://bit.ly/1z46zpa>, (qasur me 10 Tetor 2014)

⁹ Bardh Begolli, Instituti Bujqësorë i Kosovës, Intervistë me telefon, 10 Tetor 2014.

¹⁰ Ass.Dr. Antigona Ukëhaxhaj, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Prononcim i marrë nga Gazeta Zëri datë 09 Tetor 2014, <http://bit.ly/1tVBKEb>, (qasur me 13 Tetor 2014)

Vlen të përmendet se eksporti i miellit nga Kosova për në Shqipëri ishte bllokuar edhe një vit më parë, mirëpo motivi kishte qenë mungesa e analizave të aflotoksinës (substancë kancerogjene).¹¹ Në të kaluarën, kjo analizë nuk ishte kërkuar nga eksportuesit kosovar të miellit. Eksportet nga Kosova ishin lejuar të hynin në Shqipëri vetëm pasi ishin kryer analizat përkatëse nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Shqipëri. Eksporti i miellit përbën rreth 15% të eksporteve totale nga Kosova për në Shqipëri dhe njëkohësisht është produkti i dytë më i eksportuar për atje. Prandaj, çdo bllokadë e eksportit të këtij produkti është shumë e kushtueshëm për ekonominë e Kosovës.

Figura 2. Eksporti i miellit nga Kosova për në Shqipëri



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Bllokada e miellit dhe marrëveshja tregtare Kosovë- Shqipëri

Megjithëse sipas Nenit 2, pika A e marrëveshjes për tregti Kosovë-Shqipëri, qartazi theksohet se palët duhet të bashkëpunojnë për "harmonizimin gradual të legjislacionit dhe standardeve në fushën e sigurisë së produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, shëndetit të bimëve dhe kafshëve me interes të ndërsjellë", një gjë e tillë nuk ishte bërë nga ana e dy shteteve me rastin e implementimit të udhëzimit "për përcaktimin e treguesve të sigurisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t'u shitur te konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve tjera ushqimore". Kosova ka një ligj me anë të të cilit rregullohet çështja e sigurisë dhe cilësisë së miellit mirëpo ky ligj nuk e specifikon sasinë minimale të proteinave në miell.¹² Po ashtu, në Kosovë nuk ekziston një udhëzim

¹¹ Tema Online, Bllokada për Miellin e Kosovës, Zbulohet Urdhri i Ministrit Ruli, <http://bit.ly/1o8U3QQ>, (qasur me 14 Tetor 2014).

¹² Gazeta Zyrtare, Ligji Nr.04/ L-114 për Pasurimin e Miellit, <http://bit.ly/1sGN5CC>, (qasur me 10 Tetor 2014)

administrativ i cili e specifikon metodën e analizimit të treguesve të miellit, ashtu siç ekziston një i tillë në Shqipëri.¹³

Në anën tjetër, me rastin e bllokimit të miellit pala shqiptare kishte shkelur edhe pjesën e marrëveshjes sa i përket informimit dhe lajmërimit të palës tjetër. Sipas Nenit 2, pika E e marrëveshjes, palët duhet të bashkëpunojnë në *"krijimin e mekanizmave të informimit dhe lajmërimit reciprok në rastet e produkteve që nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë dhe të legjislacionit të pronësisë intelektuale"*. Në Kosovë institucioni përgjegjës për kontrollimin, verifikimin dhe inspektimin e ushqimit dhe lëndës së parë në të gjitha nivelit e zinxhirit ushqimor është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.¹⁴ Kyeshefi i AUV, z. Valdet Gjinovci kishte deklaruar se nuk kishte marrë një lajmërim zyrtar lidhur me ndryshimin e standardit të cilësisë së miellit.¹⁵ Edhe Lulëzim Demolli përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) së Kosovës kishte deklaruar se lajmin për një vendim të tillë MTI e kishte pranuar vetëm pas ngritjes së shqetësimit nga bizneset.¹⁶

¹³ Fehmi Geci dhe Bardh Begolli, Instituti Bujqësor i Kosovës, Intervistë me telefon, 10 Tetor 2014

¹⁴ Ligji Nr. 03/ L016 për Ushqimin, <http://bit.ly/1pKËEvH>, (qasur me 10 Tetor 2014).

¹⁵ Ferma Ime- Portal Informativ dhe Këshillues për Bujqësi, Bllokohet Mielli i Kosovës, Nuk i Përmblush Standardet e BE-së, <http://bit.ly/1Cd31NF>, (qasur me 10 Tetor 2014).

¹⁶ Lulëzim Demolli- MTI, Intervistë me telefon, 10 Tetor 2014.

Përfundimet dhe rekomandimet

Duke pasur parasysh partneritetin e rëndësishëm tregtar që kanë Kosova dhe Shqipëria, zbatimi i marrëveshjeve tregtare është në interes të madh ekonomik të të dyja vendeve. Në këtë analizë të shkurtë është vënë në pah problemi i dështimit të zbatimit të Nenit 2, pikës A të Marrëveshjes për Tregti në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, konkretisht problemi i harmonizimit të legjislacionit sa i përket standardeve të sigurisë dhe cilësisë së miellit.

Duke pasur parasysh se mielli dhe produktet tjera ushqimore zënë një peshë të rëndësishme në tregtinë Kosovë-Shqipëri, harmonizimi i standardeve ushqimore është i një rëndësie të veçantë. Të gjeturat tregojnë se në praktikë dy shtetet kanë dështuar në vendosjen e mekanizmave për komunikim sa i përket çështjeve të tregtisë. Moskoordinimi në mes të dy palëve shkakton bllokada dhe tensione tregtare, të cilat sjellin pasoja ekonomike për të dyja vendet.

Rekomandimet e dala nga ky punim kanë aplikim përtej eksportit të ushqimeve dhe në dobi të rritjes së tregtisë dhe rritjes ekonomike të të dyja shteteve.

Instituti GAP, rekomandon:

- Dy shtetet të trajtojnë me prioritet marrëveshjet e nënshkruara tregtare;
- Dy shtetet të konsultohen dhe të bëjnë harmonizimin e legjislacionit para implementimit të tij;
- Të bëhet standardizimi i matjeve së cilësisë dhe sigurisë së produkteve në dyja vendet;
- Sa më shpejtë të zbatohet pika e marrëveshjes e cila kërkon krijimin e grupeve punuese në fushën e fito-sanitarisë (dhe fushave tjera) në mënyrë që të bartin procesin e harmonizimit të standardeve.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.